



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 09

Datë: 27. 04. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Eshref Vishi, Ercan Spat, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi i Raportit të Punës dhe Aktivitetet të KQZ-së, për vitin 2016**
- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së**
 - **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**
 - *Asambleja gjenerale e AWEB-it;*

5. Të ndryshme

1. Hyrje

Mbledhja, është kryesuar nga znj. Vldete Daka, kryetare e KQZ-së

Valdete Daka: A ka dikush ndonjë propozim për rendin e ditës...?

Ersan Spat: Kemi marrë dy imella për rendin e ditës...! Dhe, agjenda është ndryshuar...

Enis Halimi: E kemi përmirësuar...

Ercan Spat: Çka keni përmirësuar, çka...?

Ilir Gashi: është mirë që rendi i ditës kur dërgohet, të jetë i qartë. Të mos dërgohen dy herë imella, sepse, mund të shkaktohet lajthitje...dhe jo të dërgohen imella të njëpasnjëshëm...

Sami Hamiti: Gabimet po përsëriten...Të mos përsëriten, të qartësohen gjërat dhe të mos bëhen qesharake...Bile, mbledhjet të përcaktohen në një orar, të dihet saktësisht se kur do të mbahen...

2 Shqyrtimi i Raportit të Punës dhe Aktivitetet të KQZ-së, për vitin 2016

Enis Halimi: Të nderuar, para vetës keni raportin vjetorë të KQZ-së , i cili sivjet është paksa më me vonesë për një mori arsyesh...Raporti si i këtillë, i përmban pjesët që e përshkruajnë punën që është bërë gjatë vitit 2016, duke përfshirë kornizën ligjore: aktivitetin që mbulon fushëveprimin siç është plani i punës, shërbimin votues, trajnimin, informimin publik, bashkëpunimin dhe marrëdhëniet me jashtë, anëtarësimin në ACEEO etj.

Në raport, tha z. Halimi, përfshihet edhe aktiviteti në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Drenas, pastaj dimensionet mbështetëse që kanë të bëjnë me buxhet dhe financat. Raporti, u është përmbajtur standardeve që kërkohen nga Kuvendi dhe si i tillë, i përmbushë konditat që të procedohet për miratim. Dhe pastaj, të procedohet siç duhet.

Valdete Daka: A ka dikush vërejtje në raport...?

Betim Gjoshi: Në fq. 47, pika 8 dhe 9, janë një dhe këto, mund të jenë një pikë ...!

Eshref Vishi: Mendoj se raporti ka përfshirë aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2016, duke u bazuar në planin e punës. Megjithatë, unë i kam disa vërejtje, ndoshta mund të jenë formale por, mendoj që janë edhe përmbajtjesore dhe ato, duhet të përmirësohen para se raporti të dërgohet në Kuvendin e Kosovës. Unë, tha z. Vishi, kam vërejtje të vëllimi i raportit. Për mendimin tim, raporti është tepër voluminoz, ka pjesë të raportit që mendoj se, duhet të tërhiqen... Para se të ndodh kjo, kam një pyetje për administratën: A keni ndonjë standard të raportimit në Kuvend, dhe nëse keni punuar sipas tij, ju lutem të na e prezantoni... Sepse, mua nuk më duket e mirë, nëse eventualisht, këtu kemi një përmbledhje të aktivitetëve duke u bazuar në planin e punës të vitit 2016...

E, në tërësi e kemi planin e punës të bashkangjitur të KQZ-së për vitin 2016 me aktivitet që janë zhvillu, nuk janë zhvillu...

Kisha propozuar, tha z. Vishi që të hiqet raporti për vitin 2016 që, të mos jetë pjesë e raportit për kuvend, pra të mos jetë si shtojcë... Në përmbajtjen e tij, raporti ka duplikime apo aktivitete të përsëritura, duke filluar nga përmbledhja ekzekutive. Në brendi, ka përsëritje, pastaj ka përmbajtje që duhet të fuzionohen bashkë ...Te korniza ligjore, ka ekzagjerime dhe fitohet përshtypja se Kuvendi, është duke i raportuar KQZ-së... (Z. Vishi, citoi pjesë të tekstit ku përshkruhet korniza ligjore)

Pastaj, z. Vishi tha se KQZ, nuk i ka miratuar 19 rregullore përgjatë vitit 2016 siç thuhet në raport, sepse edhe nuk janë miratuar. A, propozoi që të përmenden vetëm ato rregullore që janë miratuar gjatë këtij viti...

Në vazhdim, z. Vishi bëri disa vërejtje nga faqja nr. 10, nga faqja nr.15 ,fq. 18, dhe nga faqja nr. 20.

Betim Gjoshi: Ky raport, tha z. Gjoshi, është standard, dhe është më i mirë në strukturë se sa që kan qenë raportet e tjera... E kemi marrë me vonesë dhe ndoshta, nuk kemi mundur të bëjmë ndërhyrje, vërejtje substanciale...Lidhur me shtojcat, veç raportit financiar që është detyrim me i dërguar, pjesën tjetër, nëse nuk ka nevojë... mos e dërgoni sepse, kjo pjesë nuk e bënë më të mirë raportin...!

Valdete Daka: Disa përsëritje, sidomos neni 139 i Kushtetutës, është cituar disa herë, dhe s'ka nevojë me u cituar në çdo faqe... Te korniza ligjore, tha z. Daka, të shkurtohet dhe mendoj se pjesët tjera janë mirë ...po, edhe shtojcat...

Sami Hamiti: Raporti ka një koherencë, ka një strukturë ...Por, nëse nuk keni nevojë planin e punës mos e qoni, veç raportin financiar...

I keni shifrat, të dhënat...Kështu që, pjesën tjetër e leni...se, raporti është koherent, i ka njësitë ...

Lidhur me raportin, më tej diskutuan: Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it, Sami Hamiti, Enis Halimi etj.

Anëtarët e KQZ-së, pas shqyrtimit, miratuan unanimisht raportin vjetor 2016, i cili do t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës.

3.Raporti Këshillave të KQZ-së

Raporti i Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë

Asambleja Gjenerale e AWEB-it

Valdete Daka: Siç e dini, ne jemi pjesë e AW EB-it dhe, anëtarë të Komitetit të Auditimit... E kemi ftesën që të marrim pjesë në Asamblenë Gjenerale... Në ndërkohë, do t'i kemi specifikat se, sa anëtarë do të na ftojnë ... E shohim...

Asambleja, tha znj. Daka, do të mbahet prej 30 gusht, deri më 3 shtator 2017 në Bukuresht të Rumanisë, por nuk mund ta caktojmë numrin pa e ditur se, sa pjesëmarrës do të jemi...

Betim Gjoshi: Ne, është mirë që ta shprehim interesimin tonë, e sa shkojmë, qysh ...!

Valdete Daka: Po, ashtu është...ende s'kemi një shpjegim se sa veta duhet të marrim pjesë, por sigurisht jo më shumë se tre veta...! E kemi edhe një çështje: pagesën e anëtarësisë... Së pari, ishte dashur që ne të kuptojmë nga Qeveria se, a kanë ata ndonjë fond që mund ta mbulojnë ...Përndryshe, tha znj. Daka, duhet të shohim dhe ta paguajmë vetë ne, sepse, ju kam treguar se ato mjete shkojnë në një llogari të AWEB-it, dhe kjo llogari është e veçantë, është llogari e Kosovës...Mjetet, i shfrytëzojmë ne...

Betim Gjoshi: Le ta sjellin në mbledhjen e parë, dhe ne i themi Sekretariatit që ta paguaj...

Valdete Daka: Po, e marrim një vendim ne, dhe pastaj, të paguhet... Edhe një çështje... E kemi një ftesë nga Kroacia në kuadër të ACEEO-së për vëzhgimin e zgjedhjeve në Kroaci që, do të mbahen më 21 maj 2017...Fjala është për Zgjedhjet Lokale...

4. Të ndryshme

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
